



Ministria e Shëndetsisë



Instituti i Shëndetit Publik

MDG  F
MDG ACHIEVEMENT FUND



United Nations
ALBANIA

VLERËSIMI I OBEZITETIT NË MOSHËN FËMINORE

INSTITUTI I SHËNDETIT PUBLIK
TIRANË, MAJ 2013

Autorët e raportit

Jolanda Hyska

Genc Burazeri

Ehadu Mersini

Design & Shtypi

Shtëpia botuese & Shtypshkronja "Pegi"

Desinger

Elvis Bejtja

ISBN: 978-9928-162-70-0

BOTIME **Botime Pegi:** tel: +355/ (0)42 374 947; cel: +355/(0)69 40 075 02;
e-mail: botimepegi@botimepegi.al; web: www.botimepegi.al
Shtypshkronja Pegi: cel: +355/(0)69 40 075 01;
e-mail: shtypshkronjapegi@yahoo.com



Përmbajtja e lëndës

Sfondi	7
1. Obeziteti dhe mbipesha	7
2. Trendi global i obezitetit tek fëmijët.....	8
3. Situata e mbipeshës dhe e obezitetit në Shqipëri.....	10
4. Mjediset shkollore	12
1. Qëllimi dhe objektivat	13
2. Metodologjia e studimit të obezitetit në fëmijët e moshës shkollore 8-9 vjeç.....	13
3. Popullata në studim.....	13
4. Metoda e kampionimit	14
5. Mënyra e përfshirjes dhe e menaxhimit të fëmijëve që munguan ose që refuzuan.....	15
6. Mjetet dhe materialet e sistemit të vlerësimit	16
7. Trajnimi i stafit të përfshirë në studim dhe mënyra e mbledhjes të të dhënave.....	17
8. Krijimi i databazës dhe analiza e të dhënave	18
9. Përkufizimet e përdorura	19
10. Klasifikimi i mëngjesit	21

11. Gabimet sistematike (“bias”) të mundshme	21
12. Financimi i këtij studimi	22
13. Rezultate dhe diskutime	22
A. Gjendja nutricional e fëmijëve	22
B. Mjediset shkollore	35
14. Diskutime dhe përfundime.....	38
15. Rekomandime.....	41
Referencat.....	44
ANEX 1 Shkresa e bashkëpunimit nga Ministria e Arsimit dhe e Shkencës.....	49
ANEX 2 Letra e informimit për prindërit	51
ANEX 3 Formulari i ekzaminuesit për fëmijën	54
ANEX 4 Formulari i ekzaminuesit për t’u kthyer nga shkolla	57
ANEX 5 Lista e shkollave të përfshira në studim	60
ANEX 6 Lista e personelit të përfshirë në realizimin e studimit.....	64

Shkurtime

ADHS	Studimi Demografik dhe Shëndetësor Shqiptar
COSI	Iniciativa për Vlerësimin e Obezitetit në Moshën Fëminore
IOFT	Task Forca Ndërkombëtare e Obezitetit
ISHP	Instituti i Shëndetit Publik
BMI	Treguesi i masës trupore ¹
OBSH	Organizata Botërore e Shëndetësisë

¹ Body Mass Index

Falënderim

Një falënderim i veçantë i drejtohet:

- Organizatës Botërore të Shëndetësisë, Zyrës së Tiranës dhe Zyrës për Evropën që në sajë të mbështetjes së gjerë teknike dhe financiare në kuadrin e Programit të Përbashkët të Ushqyerjes “Zvogëlimi i kequshqyerjes tek fëmijët”, financuar nga Fondi Spanjoll i Objektivave të Zhvillimit të Mijëvjeçarit, bënë të mundur realizimin me sukses të këtij studimi.
- Fëmijëve të mrekullueshëm, të cilët pa hezituat asnjëherë u bënë bashkëpunëtorët tanë më të mirë në këtë ndërmarrje të përbashkët.
- Ekipit kombëtar të koordinimit të studimit.

Falënderojmë gjithashtu për kontributin e çmuar:

- Ministrinë e Shëndetësisë
- Ministrinë e Arsimit dhe të Shkencës
- Stafin drejtues dhe pedagogjik të shkollave në studim
- Të gjithë personelin e përfshirë në zbatimin e studimit

Një mirënjohje e veçantë është për Dr. Ehadu Mersini dhe Zj.Trudy Wijnhoven (OBSH), për konsulencën e tyre të vlefshme teknike.

Sfondi

1. Obeziteti dhe mbipesha

Obeziteti në fëmijëri është quajtur me të drejtë një nga sfidat më të mëdha të shëndetit publik për shekullin e 21-të (1). Obeziteti ka një natyrë shumëfaktoriale dhe karakterizohet nga një grumbullim i tepërt i indit dhjamor, një rritje e peshës trupore dhe si rrjedhojë edhe e riskut për shëndet (2, 3).

Mes sjelljeve kryesore me risk që kontribuojnë në mbipeshën dhe obezitetin përmendim me siguri: konsumin e tepërt të ushqimeve, veçanërisht të atyre me densitet të lartë energjetik (3-5), zakonin për të mos ngrënë mëngjes (6-10), konsumimin e pamjaftueshëm ditor të frutave dhe të perimeve (11), praktikimin e pakët të aktivitetit fizik (12, 13) dhe tejkalimin me sjellje sedentare mes të cilave, përdorimi i televizorit dhe i kompjuterit (14-16), fenomen i ndeshur sidomos në moshat e reja të popullatës (17-20).

Faktorët e rritjes së obezitetit, të regjistruar në vitet e fundit, janë shumëfishuar. Nga njëra anë bëhet fjalë për zakone dhe faktorë risku të modifikueshëm, që iu atribuohen sjelljeve individuale (21) që gjithsesi janë të lidhura me dinamikat komplekse kolektive, që përfshijnë shoqërinë, familjen, institucionet, madje edhe organizatat sociale fetare dhe masmedian (22).

Obeziteti mund të dëmtojë çdo sistem të trupit të fëmijës: zemrën, muskujt, kockat, veshkat dhe traktin tretës, ashtu sikurse hormonet që kontrollojnë sheqerin në gjak dhe pubertetin. Ai shoqërohet edhe me një kosto të rëndë sociale dhe emocionale (23).

Për më tepër, të rinjtë që janë mbipeshë ose obezë kanë më shumë gjasa të jenë mbipeshë ose obezë edhe në moshë të rritur (24), duke rritur riskun e tyre për sëmundje apo paaftësi gjatë jetës.

Shifrat tregojnë se në nivel global, në vitin 2010, rreth 43 milionë fëmijë të moshës parashkollore (nën 5 vjeç) ishin mbipeshë ose obezë, duke u karakterizuar nga një rritje e kësaj shifre prej 60%, e krahasuar me shifrat para vitit 1990 (25).

Problemi ndeshet si në vendet e pasura edhe në vendet e varfra. Nga 43 milionë fëmijë mbipeshë ose obezë të moshës parashkollore, 35 milionë jetojnë në vendet në zhvillim. Në vitin 2020, nëse kjo epidemi do të vazhdojë që të mos ulet, 9 për qind e të gjithë fëmijëve të moshës parashkollore do të jetë mbipeshë ose obeze, e thënë në shifra afërsisht 60 milionë fëmijë (25).

Niveli i obezitetit është më i lartë tek të rriturit në raport me fëmijët. Por në terma relative në vende si SHBA-ja, Brazili, Kina apo vende të tjera është vënë re se problemi përparon më shpejt tek fëmijët në krahasim me të rriturit (26).

Sigurisht që në disa rajone si Azia Juglindore dhe Afrika Subsahariane ende luftohet kundër urisë së fëmijëve (27). Por globalizimi e ka bërë botën më të pasur, dhe mirëqenia dhe pesha janë të lidhura me njëra-tjetrën.

Duke qenë se në vendet e varfra niveli i të ardhurave vjen duke u rritur, dhe dieta tradicionale ndryshon drejt asaj perëndimore. Këta faktorë bëjnë që edhe niveli i obezitetit të rritet (28). Një rezultat i të ashtuquajturit tranzicion nutricional është se vendet me të ardhura të ulëta ose të mesme shpesh përballen me një barrë të dyfishtë të sëmundjes: sëmundjet infektive që shoqërojnë kequshqyerjen, veçanërisht në fëmijëri, dhe sëmundjet kronike, gjithmonë në rritje, të lidhura me obezitetin dhe stilin perëndimor të jetesës.

2. Trendi global i obezitetit tek fëmijët

Në tri dekadat e fundit, niveli i obezitetit në SHBA është trefishuar dhe sot vendi ka një nga nivelet me të larta në botë të mbipeshës dhe të obezitetit: një në gjashtë fëmijë është obez dhe një në tre fëmijë është mbipeshë ose obez (29). Që prej vitit 2008, ky nivel ka mbetur i pandryshuar, më pas disa grupe kanë vazhduar të shohin rritje, ndërsa disa grupe kanë nivele më të larta se

të tjerët. Në vitet 1970, 5 për qind e fëmijëve 2-18 vjeç ishin obezë (sipas përkufizimit të sotëm të CDC-së për obezitetin), në vitin 2008, rreth 17 për qind e fëmijëve ishte obezë, përqindje e cila mbeti e pandryshuar edhe në vitin 2010 (29, 30).

Në Kanada është vënë re gjithashtu një rritje e obezitetit tek fëmijët, pasi që nga vitet '70, në përgjithësi, obeziteti është dyfishuar, dhe në disa grupe edhe trefishuar (31). Por niveli i obezitetit paraqitet pak më i ulët se në SHBA. Në vitet 2007-2008 rreth 9 për qind e fëmijëve kanadezë të moshës 6-17 vjeç ishin obezë, bazuar në vlerat limit të IOTF-së.

Edhe pse të dhënat për Amerikën Latine dhe Karaibet janë të pakta, është e qartë se mbipesha dhe obeziteti i moshës fëmimore është bërë një problem i ndjeshëm, pasi në përgjithësi në rajon ka më shumë fëmijë mbipeshë se nëneshë. E thënë në shifra, 7 për qind e fëmijëve të moshës nën pesë vjeç, në vitin 2010, rezultonte mbipeshë ose obeze, kundrejt një uljeje të ndjeshme të nëneshës nga 7 për qind në vitin 1990 në 3 për qind në vitin 2010 (25, 27), referuar standardeve të rritjes së OBSH-së.

Uria, nënpesha dhe prapambetja në rritje (stunting) kanë qenë më të pranishme në fëmijët e Afrikës, duke u ndeshur akoma edhe në ditët e sotme, ku 20-25 për qind e fëmijëve të moshës parashkollore në Afrikën Subsahariane janë nënpeshë (27). Megjithatë edhe niveli i obezitetit është duke u rritur. Kështu, numri i fëmijëve të moshës parashkollore mbipeshë dhe obezë gjatë dy dekadave të fundit është dyfishur nga 4 për qind në vitin 1990 në 8.5 për qind në vitin 2010, një shifër veçanërisht e ndjeshme për Afrikën Veriore, ku një në gjashtë fëmijë është mbipeshë ose obez. (25)

Edhe pse uria tek fëmijët është çështja më e prekshme nutricional për pjesën më të madhe të Azisë (si Azia e Jugut, p.sh., ku një në tre fëmijë është nënpeshë) rajoni po ndeshet edhe me një rritje dramatike të obezitetit te fëmijët. Kështu, në të gjithë Azinë (përfshirë Japoninë) rreth 5 për qind e fëmijëve të moshës parashkollore në vitin 2010 vlerësohej mbipeshë ose obeze me një rritje prej 53 për qind të prevalencës së para viteve 1990 (25). E thënë ndryshe, rreth 17.7 milionë fëmijë aziatikë janë mbipeshë ose obezë.

Përsa i përket Evropës, çuditërisht ajo paraqitet me të dhëna jo të përfunduara për sa i përket trendit të obezitetit, veçanërisht për vendet e Evropës Lindore. Deri vonë këto të dhëna nuk janë mbledhur në mënyrë konsistente në të gjithë kontinentin, duke e bërë të vështirë krahasimin e

të dhënave midis shteteve. Megjithatë nga analiza e të dhënave të disponueshme vihet re se në dy dekadat e fundit niveli i obezitetit mes fëmijëve, në shumë vende është rritur (32, 33). Së fundi, mes disa grup-moshave të disa vendeve ky nivel duket se ka arritur një *plateau*.

Mbipesha dhe obeziteti i fëmijëve të moshës 4-vjeçare, të matur në 27 vende të Evropës, tregoi ndryshime mes tyre, me prevalencën më të lartë të ndeshur në Spanjë (32 për qind) dhe vlerën më të ulët në Rumani me 12 për qind (33).

Qiproja, Greqia, Spanja dhe Anglia paraqiten me nivelin më të lartë të obezitetit mes fëmijëve të moshës 10-18 vjeç të 30 shteteve të studiuara (32). Por sërish të dhënat janë të kufizuara dhe cilësisht të ndryshme.

Përsa u përket fëmijëve të moshës shkollorë 6-9.9 vjeç, Iniciativa e Organizatës Botërore të Shëndetësisë për vlerësimin e obezitetit në moshën fëmimore, së fundi ka filluar të ndjekë nivelet e obezitetit tek fëmijët në rreth 15 vende, duke përdorur standardet e rritjes së fëmijëve të OBSH-së. Analiza e parë, bazuar në të dhënat e viteve 2007-2008 të 13 shteteve, nxori në pah se 24 për qind e fëmijëve të moshës 6-9 vjeç janë mbipeshë, duke u hasur në një interval nga 19% në 49% mes djemve dhe nga 18% në 43% mes vajzave, dhe një interval obeziteti nga 6% to 26.6% mes djemve dhe nga 5% në 17% (34) mes vajzave. Prevalenca me e lartë e mbipeshës u vu re në Itali, Portugali dhe Slloveni (bazuar në referencat e rritjes së fëmijëve të OBSH-së, 2007) (35).

Një fazë e dytë e mbledhjes së të dhënave është kryer në vitin 2010 me përfshirjen e 17 shteteve.

Në vazhdim, katër shtete të tjera, mes tyre edhe Shqipëria, u është bashkuar shteteve pjesëmarrëse në fazën e tretë të mbledhjes së të dhënave për vitin shkollor 2012-2013.

3. Situata e mbipeshës dhe e obezitetit në Shqipëri

Në Shqipëri, mbipesha dhe obeziteti janë një faktor risku i rëndësishëm për shëndetin, veçanërisht për sëmundjet jo të transmetueshme. Ky faktor risku vepron që në moshën e fëmijërisë. Të dhënat e një studimi të kryer nga ISHP-ja (36) treguan që 15.2% e fëmijëve të moshës 9-10 vjeç janë mbipeshë, prej të cilëve 3.8% janë obezë. Të dhënat e ADHS-së, 2008-2009, nxorën në pah se rreth 22 për qind e fëmijëve të moshës nën pesë vjeç janë mbipeshë ose

obezë, ndërkohë që mes të rriturve mbi 15 vjeç, 53% e meshkujve 15-49 vjeç ishin mbipeshë (prej të cilëve 9% obezë) dhe 39% e grave të së njëjtës grup-moshë rezultuan mbipeshë (prej të cilave 10% obeze) (37).

Nuk është asnjëherë shpejt të fillojmë parandalimin e obezitetit. Të dhënat më lart tregojnë se edhe tek fëmijët e vegjël niveli i obezitetit është duke u rritur në të gjithë globin. Gjithashtu, është mëse e qartë se për çdo individ mbipeshë është shumë e vështirë të humbë peshë, pavarësisht nga mosha. Parandalimi i obezitetit që në vitet e para të jetës (edhe para lindjes nëpërmjet zakoneve të shëndetshme gjatë shtatzënisë) konfirmon një jetë të shëndetshme. Dhe kjo është rruga më premtuese për të përmbysur këtë epidemi globale. (38)

Aspekti më shqetësues i obezitetit te fëmijët është se këta fëmijë mbeten obezë edhe në moshë të rritur, duke zhvilluar kështu patologji më të rënda, që kanë tendencë të çojnë në reduktimin e cilësisë dhe të jetëgjatësisë. Në fakt, zakonet e përfutuara në fëmijëri, lidhur me dietën dhe aktivitetin fizik nuk ndryshojnë lehtësisht gjatë jetës.

Prandaj parandalimi dhe frenimi i rritjes së obezitetit në moshën fëmimore paraqet sot një sfidë për shëndetin publik, pasi është shumë i vështirë trajtimi i obezitetit të instaluar, është shumë i lartë probabiliteti i të qenit një adoleshent apo adult obez, është i vështirë korrigjimi i zakoneve të gabuara të të ushqyerit në moshë të rritur, të fituara që në fëmijëri (36).

Nevoja për të ndjekur me vëmendje gjendjen nutricionalë dhe zakonet e jetës së popullatës në përgjithësi, dhe të fëmijëve në veçanti motivohet nga implikimet që ato kanë direkt mbi shëndetin e fëmijëve, dhe sepse ata përbëjnë faktorët e riskut për shfaqjen e obeziteti dhe patologjive në moshë të rritur.

Për monitorimin e evolucionit në kohë të obezitetit te fëmijët dhe vlerësimin e ndërhyrjeve promociionale të kryera për shëndetin, Shqipëria po fuqizon sistemin e vlerësimit nutricional në moshën fëmimore.

Plani Kombëtar i Veprimit për Ushqimin dhe Ushqyerjen i ka kushtuar një fokus të veçantë kontrollit dhe reduktimit të mbipeshës dhe obezitetit të popullatës shqiptare në përgjithësi, dhe fëmijëve të vegjël në veçanti, duke planifikuar edhe një sërë aksionesh ndërhyrëse dhe të vazhdueshme në nivel kombëtar dhe lokal për përmbushjen e këtij objekti, nën optikën e një përjasjeje të integruar për reduktimin e faktorëve të riskut, të lidhur me sëmundjet kronike, ku bën pjesë edhe obeziteti.

4. Mjediset shkollore

Shkolla luan një rol kyç në luftën kundër obezitetit tek fëmijët dhe të rinjtë duke inkurajuar, nëpërmjet zbatimit të politikave specifike dhe promovimit të zakoneve të shëndetshme ushqyese dhe aktivitetit fizik, zgjedhje të vetëdijshme për sjellje të shëndetshme mes të rinjve (39).

Organizata Botërore e Shëndetësisë thekson se masat politike dhe arsimore brenda mjediseve shkollore përfaqësojnë një mundësi të mirë për të ndikuar pozitivisht në shëndetin e të rinjve (40, 41).

Sot ka shumë dëshmi shkencore mbi efektshmërinë e ndërhyrjeve të kryera në shkollë, sidomos atyre afatgjata, në parandalimin e mbipeshës në moshën fëminore (42-45).

Në Shtetet e Bashkuara, që nga viti 2007, në institucione të ndryshme janë zbatuar programe për parandalimin e obezitetit që kanë pasur të bëjnë me përfshirjen dhe trajnimin e mësuesve, si dhe zbatimin progresiv të politikave që synojnë reduktimin e këtij fenomeni në rritje (46, 47).

Në Evropë, projekti HEPS (Ushqyerja e Shëndetshme dhe Aktiviteti Fizik në Shkollë) (48), i lidhur me rrjetin SHE (Shkolla për Shëndet në Evropë) (49), mbështet shtetet evropiane në promovimin e një ushqyerjeje të shëndetshme dhe të aktivitetit fizik, përmes programeve shkollore gjithëpërfshirëse, të qëndrueshme dhe të bazuara në evidencë.

Në Shqipëri, shkolla mbulon një periudhë kohore të rëndësishme për të mësuarin dhe formimin e identitetit të nxënësve, gjatë së cilës krijohen bazat dhe zhvillohen aftësitë e nevojshme për të vazhduar të nxënësve përgjatë gjithë jetës. Kështu, shkolla përbën vendin ideal për të promovuar shëndetin dhe rritjen e shëndetshme të fëmijëve, jo vetëm nëpërmjet programeve të edukimit nutricional dhe të aktivitetit fizik, por edhe nëpërmjet iniciativave të promovimit të një stili jete të shëndetshëm, edhe për familjet e këtyre nxënësve.

1. Qëllimi dhe objektivat

Ky studim, si pjesë e sistemit të vlerësimit të obezitetit fëminor në Shqipëri, synon mbledhjen, analizën, interpretimin dhe shpërndarjen e informacionit përshkrues për monitorimin e peshës së tepërt trupore tek fëmijët e moshës fëminore (e identifikuar tashmë si një problem serioz i shëndetit publik në nivel evropian (50), dhe përdorimin e këtij informacioni për të kuptuar progresin e epidemisë, dhe për të planifikuar dhe për të ndërmarrë aksione për ta ndryshuar atë (51).

Ky studim, për herë të parë, do të jetë pjesë e sistemit të vlerësimit të të dhënave rutinë, që ofrojnë informacione më të mira për të kuptuar drejt dhe saktë problemin e obezitetit tek fëmijët (52), në nivel evropian – COSI (*Childhood Obesity Surveillance Initiative*).

Zbatimi i këtij sistemi të mbikëqyrjes së thjeshtë, të standardizuar, të harmonizuar dhe të qëndrueshme synon në mbushjen e boshllëkut aktual në informacionet gjatësore (*longitudinale*) në statusin e ushqyerjes, në trajtimin dhe monitorimin e epidemisë së obezitetit tek fëmijët dhe në identifikimin e grupeve në rrezik.

2. Metodologjia e studimit të obezitetit në fëmijët e moshës shkollore 8-9 vjeç

Metodologjia e përdorur është ajo studimit të një kampioni të përzgjedhur (fëmijë që frekuentojnë klasat e shkollave fillore të vendit). Matjet në klasë përfshijnë periudhën nga fillimi i muajit shkurt deri në javën e fundit të muajit mars 2013.

3. Popullata në studim

Popullata në studim përbëhet nga fëmijë që frekuentojnë respektivisht klasat e 2-ta dhe të 3-ta të shkollave të sistemit 9-vjeçar të vendit. Zgjedhja e studimit të kësaj grup-moshe lidhet me riskun e lartë të obezitetit (22-24), me ndikimin akoma të paktë të pubertetit në rritje, si dhe nga aftësia që kanë fëmijët e kësaj moshe për t'iu përgjigjur disa pyetjeve të thjeshta (25).

Gjithashtu, edhe Organizata Botërore e Shëndetësisë kërkon në kuadrin e vlerësimit të obezitetit tek fëmijët në nivel evropian (*European Childhood Obesity Surveillance Initiative-COSI*), mbledhjen e të dhënave pikërisht të grup-moshave 6-9 vjeç (26).

Duke qenë se Shqipëria ka tashmë një studim në nivel kombëtar të grup-moshës 9-10 vjeç, duke marrë në konsideratë vështirësitë teknike të përzgjedhjes së moshës 6-7 vjeç (për arsye të gjendjes së kësaj grup-moshe në dy nivele arsimore dhe paraarsimore do të duhej një buxhet aktualisht i papërballueshëm për kryerjen studimit), si dhe përballë vështirësisë së kapjes së grup-moshës së fëmijëve 7-8 vjeç në shkolla gjatë së njëjtës periudhë kohore të kryerjes së mësimit, u mendua se grup-mosha 8-9 vjeç ishte me përshtatshmja për kryerjen e studimit për kushtet aktuale të zbatimit të tij.

4. Metoda e kampionimit

Metoda e kampionimit të përdorur është: kampion me grupe (klastera) në dy faza/stade, në përputhje me metodologjinë e përshkruar në literaturën ndërkombëtare për studime të këtij lloji (53).

Në këtë fazë të parë të mbledhjes së të dhënave në Shqipëri, u ndërmor një studim i tipit transversal (kros-seksional) i cili përfshi një kampion përfaqësues në nivel kombëtar të fëmijëve të moshës 8.0-8.9 vjeç. Përshkrimi i detajuar i teknikës së kampionimit paraqitet më poshtë:

a) Skema e kampionimit (54)

- Kampionim me grupe (klastera) në dy faza/stade.
- Në fazën/stadin e parë, u përftua një kampion i rastësishëm i thjeshtë me probabilitet në funksion të madhësisë prej 104 (shih më poshtë piken “d”) shkollash fillore publike (shkollat speciale u përjashtuan nga korniza e kampionimit meqenëse më pak se 1% e fëmijëve të shenjëstruar bënë pjesë në shkolla të tilla në vendin tonë). Kështu, njësitë primare të kampionimit ishin shkollat fillore publike.
- Në fazën/stadin e dytë, për secilën shkollë të kampionuar në stadin e parë (Nr=104), u ndërmor një stratifikim (shtresëzim) sipas klasave (klasa e dytë vs. klasës së tretë) meqenëse fëmijët e grup-moshës së targetuar për këtë studim (d.m.th. grup-mosha 8.0-8.9 vjeç) u përkasin të dyja këtyre klasave (d.m.th. fëmijët e kësaj grup-moshe mund të gjenden si në klasë të dytë ashtu edhe në klasë të tretë).

Pas shtresëzimit sipas klasave (d.m.th. klasa e dytë vs. klasës së tretë), u përftua në kampion nga një klasë e dytë dhe nga një klasë e tretë në mënyrë të rastësishme të thjeshtë nga secila prej 104 shkollave të përzgjedhura në stadin e parë të kampionimit. Kështu, njësitë sekondare të kampionimit ishin klasat.

- b) Numri i shkollave të përfshira në kampion: 104 shkolla.
- c) Numri i klasave të përfshira në kampion: $104 * 2 = 208$ klasa (dy klasa për secilën shkollë).
- d) Llogaritja e madhësisë së kampionit u bazua në supozimet e mëposhtme:
 - Niveli i pjesëmarrjes në studim: 90% (ky në fakt është një supozim konservativ i cili tenton që të maksimalizojë madhësinë e kampionit, sepse studime të mëparshme në Shqipëri kanë dëshmuar një shkallë pjesëmarrjeje më të lartë); bazuar në një nivel pjesëmarrjeje prej 90%, numri i nevojshëm i nxënësve duhej të ishte ≈ 3100 (në vend të numrit prej ≈ 2800 për një kampion të rastësishëm të thjeshtë).
 - Efekti i studimit: 1.2 (bazuar në analizën e studimit HBSC (54).
 - Numri i nxënësve për klasë: 15 (ky ishte gjithashtu një supozim konservativ, i cili tenton të maksimalizojë madhësinë e kampionit të klasave të përfshira në studim meqenëse numri mesatar i nxënësve për klasë në vendin tonë është ≈ 20).
 - Meqenëse për secilën shkollë të përzgjedhur, u përfshinë dy klasa (një klasë e dytë dhe një klasë e tretë), numri i nevojshëm i shkollave ($N=104$) u llogarit si më poshtë vijon:

$$\text{Numri i nevojshëm i shkollave} = 3100 / 30 \approx 104$$

5. Mënyra e përfshirjes dhe e menaxhimit të fëmijëve që munguan ose që refuzuan

Në studim u përfshinë të gjithë fëmijët e klasave të II dhe të III të përzgjedhura nga kampionimi, të pranishëm në ditën e kryerjes së matjeve antropometrike, pavarësisht nga mosha e tyre. Nuk u parashikua asnjë rikthim në klasë për fëmijët që mungonin në ditën e matjeve. Ishte parashikuar që fëmijët, prindërit e të cilëve nuk do të lejonin pjesëmarrjen në matje të mos përfshiheshin. Gjithsesi nuk pati asnjë refuzim nga ana e prindërve lidhur me pjesëmarrjen e

fëmijëve të tyre në këtë studim, po kështu edhe nga ana e fëmijëve gjatë procesit të matjeve antropometrike në klasa. Edhe përsa u përket fëmijëve me defekte të rënda fizike ata u matën, por rezultatet e këtyre matjeve nuk u përfshinë në databazë për t'u analizuar. Nuk u refuzua asnjë kërkesë nga ana e stafit të shkollave lidhur me kryerjen e matjeve antropometrike të fëmijëve të tjerë, por pa i përfshirë ato në analizën e kampionit tonë.

6. Mjetet dhe materialet e sistemit të vlerësimit

Pranë Institutit të Shëndetit Publik, Sektorit të Ushqyerjes dhe të Ushqimit u përgatitën materialet e nevojshme për realizimin e mbledhjes së të dhënave në përputhje me protokollin e mbledhjes së të dhënave sipas COSI-t , të cilat përfshinë si më poshtë vijon:

- Modelin e letrës së informimit dhe të bashkëpunimit të stafit drejtues të shkollave dhe stafit pedagogjik, si dhe të prindërve lidhur me iniciativën për vlerësimin e rritjes së fëmijëve (shih: ANEX 1, shkresa e bashkëpunimit nga Ministria e Arsimit dhe e Shkencës)
- Modelin e letrës së informimit për prindërit, lidhur me iniciativën për vlerësimin e rritjes së fëmijëve dhe lejes për përfshirjen e fëmijës së tij/saj në këtë studim. (ANEX 2)
- Formularin e ekzaminuesit për fëmijën (ANEX 3)
- Formularin e ekzaminuesit për t'u kthyer nga shkolla (ANEX 4)

Në veçanti, për mbledhjen e informacionit që kishte të bënte me gjendjen nutricionalë të fëmijës, zakoneve të tyre ushqyese dhe disa karakteristikave të mjediseve shkollorë u përgatitën 2 formularë: një i cili plotësohej nga ekzaminuesit në klasë dhe kishte të bënte me fëmijën, dhe një i destinuar për t'u plotësuar nga stafi drejtues i shkollës ose nga mësuesit e klasave të përzgjedhura në studim, dhe kishte të bënte me mjediset shkollorë.

Formulari i fëmijëve përbëhej nga 21 pyetje lidhur me të dhënat demografike, dhe statusin fizik në momentin e kryerjes së matjeve antropometrike, pasi fëmija ka pranuar t'u nënshtrohet këtyre matjeve. Së fundi, fëmija pyetet lidhur me konsumimin e vaktit të mëngjesit dhe të drekës.

Formulari i shkollave siguroi mbledhjen e informacionit mbi disa karakteristika të mjediseve shkollorë, të cilat mund të ndikojnë në favor të shëndetit të fëmijës.

Në pyetjet e formuluar për drejtuesit e shkollave, vëmendje e veçantë i kushtohet informacionit lidhur me aktivitetin fizik të fëmijëve, të përfshirë në programin mësimor, si dhe mjediset apo palestrat që shfrytëzoheshin nga fëmijët; iniciativave të ndryshme për promovimin e një mënyre jetese të shëndetshme për fëmijët e klasave në studim; pranisë së automateve apo pikave të shitjes së ushqimeve dhe pijeve, si dhe të produkteve ushqimore që fëmijët sigurojnë nëpërmjet tyre, duke përfunduar me një informacion të reduktuar lidhur me sigurinë e rrugëve përreth shkollës, për frekuentimin e tyre me biçikleta apo në këmbë nga ana e fëmijëve.

Matjet antropometrike të fëmijëve u kryen nëpërmjet peshoreve dhe stadiometrave të lëvizshëm të markës Seca.

Matja e peshës u krye me anë të peshoreve Seca 813, me një shkallë saktësie ± 100 gr dhe kapacitetet matjeje 200 kg, si dhe stadiometrave të lëvizshëm Seca 213 me shkallë saktësie ± 1 mm dhe interval matjeje nga 20-205 cm. Sigurimi i 10 seteve të këtyre mjeteve u bë falë mbështetjes që ISHP-ja pati nga Organizata Botërore e Shëndetësisë.

7. Trajnimi i stafit të përfshirë në studim dhe mënyra e mbledhjes së të dhënave

Për realizimin me sukses të këtij studimi u krye përzgjedhja e personelit që do të realizonte studimin në të gjithë hapat e tij, si dhe trajnimi i të gjithë stafit të përzgjedhur.

Trajnimi katërditor konsistoi në:

- *Familjarizimin me COSI-n*, përshkrimin e sfondit dhe të objektivave të këtij sistemi vlerësimi, udhëzimet e detajuara mbi procesin dhe rezultatet e projektit.
- *Përdorimin e standardizuar të formularëve*, sipas përshkrimit në protokoll (formulari i detyrueshëm i ekzaminuesve, formulari i detyrueshëm për t'u kthyer nga shkollat, dhe formulari vullnetar i shkollave).
- *Ekzaminimi antropometrik sipas një procedure të paracaktuar nga OBSH-ja*. (Shënimi i vlerave të matjeve menjëherë pas leximit të tyre; aplikimi i një shkrimi të lexueshëm për të zvogëluar gabimet gjatë transferimit të të dhënave, respektimi rigoroz i teknikave

të matjeve dhe procedurave të regjistrimit, procedurat e kalibrimit të instrumenteve matëse, mirëmbajtja, ruajtja dhe transportimi i instrumenteve.)

- *Konsideratat etike dhe çështje të tjera të rëndësishme.* (Konsiderata etike lidhur me parimet themelore të privatësisë, konfidencialitetin dhe objektivitetin e të gjithë procesit; konsiderata etike mbi mbështetjen për fëmijët “e frikësuar”, dhe parandalimin e stigmatizimit apo ngacmimit të fëmijëve vulnerabël; konsiderata etike mbi adresimin e pyetjeve nga fëmijët, stafi i shkollës apo prindërit).
- *Trajnim 1-ditor i operatorëve dhe i administratorit të të dhënave lidhur me të gjitha aspektet që kanë të bëjnë me procesimin dhe menaxhimin e të dhënave të studimit.* (Praktikimi i hedhjes së të dhënave në databazë, praktikimi i menaxhimit të të dhënave në databazë.)

Me qëllim standardizimin e ekzaminuesve që do të kryenin punën në terren u krye aplikimi praktik dyditor i procedurave të punës në terren në lidhje me përdorimin e standardizuar të formularëve, përputhshmërisë së tyre me procedurat e mbledhjes së të dhënave, si dhe lidhur me teknikat e kryerjes së matjeve antropometrike dhe procedurave të shkrimit të të dhënave. Ky trajnim praktik u krye në dy shkolla të qytetit të Tiranës (shkolla “Mihal Grameno” dhe “Fan Noli”).

8. Krijimi i databazës dhe analiza e të dhënave

Të gjitha të dhënat u hodhën në SPSS (*Statistical Package for Social Sciences*), versioni 19.0.

Analiza e të dhënave konsistoi në përshkrimin e variablave (mesataret dhe shmangiet standarde për variablat numerikë dhe frekuencat për variablat kategorikë) si dhe në aplikimin e testeve statistikore për krahasimin e prevalencës së nënpeshës, mbipeshës dhe obezitetit tek fëmijët. Në mënyrë specifike, testet statistikore të përdorura në analizën aktuale konsistuan në procedurat e mëposhtme:

- Testi *hi-katror* dhe testi ekzakt i Fisherit për krahasimin e prevalencës së mbipeshës dhe obezitetit tek fëmijët sipas gjinisë (meshkuj vs. femra), vendbanimit (fshat vs. qytet), apo rrethit të përfshirë në studim.
- Regresioni logjistik binar u përdor për vlerësimin e raportit të gjasave të mbipeshës

dhe obezitetit tek fëmijët. Modelet fillestare konsistuan në analizë bivariate (d.m.th. vlerësimi i raportit të gjasave “bruto”, ose të paaxhustuar për variablat e tjerë). Më pas, u aplikuan modele të regresionit shumëndryshorësh (analizë multivariate) e cila konsistoi në vlerësimin e raportit të gjasave të mbipeshës dhe obezitetit tek fëmijët pas kontrollit të njëkohshëm (simultan) për të gjithë variablat apo karakteristikat e fëmijëve të përfshirë në studim. Në çdo rast (pra, si për modelet e paaxhustuara, ashtu edhe për modelet multivariate), u llogaritën raportet e gjasave (OR), intervalet e besimit 95% si dhe vlerat e sinjifikancës (përfillshmërisë apo domethënies) statistikore.

- Koeficientët e korrelacionit Pearson dhe Spearman u përdorën për vlerësimin e lidhjeve (shoqërimeve) lineare të variablave numerikë.
- Për të gjitha procedurat statistikore të aplikuara, u konsideruan si statistikisht të përfillshme (sinjifikante) vlerat e $P \leq 0.05$.

9. Përkufizime të përdorura

Për përcaktimin e gjendjes së mbipeshës dhe të obezitetit në këtë studim u përdor indikator indirekt i vlerësimit të kësaj gjendjeje BMI (*Body Mass Index –Treguesi i Masës Trupore*). Për përcaktimin *nënpeshë, normal, mbipeshë* dhe *obez* të fëmijëve u zgjodhën për t’u përdorur vlerat kufi të përcaktuara si nga OBSH-ja (Organizata Botërore e Shëndetësisë) edhe nga IOTF-i (*International Obesity Task Force*), (Figura 1 dhe 2).

Në vitin 2007, OBSH-ja ka propozuar vlera të reja kufi (55) për përkufizimin e peshës së tepërt tek fëmijët, të cilat më pas i ka përshtatur në kuadrin e projektit *Childhood Obesity Surveillance Initiative* (COSI) të OBSH-së për rajonin e Evropës (56), në të cilin Shqipëria është pjesëmarrëse për herë të parë, në fazën e tretë të mbledhjes së të dhënave, për vitin shkollor 2012-2013.

Këto vlera kufi janë më të ulëta se ato të Cole Jt et al. dhe, si rrjedhojë, për të njëjtën BMI përqindja e fëmijëve mbipeshë dhe obezë rezulton të jetë më e lartë.

Ndërkohë vlerat kufi të BMI-së për mbipeshën dhe obezitetin, të përcaktuara nga Cole Jt et al (57) janë të pranuar universalisht nga i gjithë komuniteti shkencor për përdorimin në studime epidemiologjike, si dhe të rekomandueshme për krahasim ndërkombëtar të prevalencës së mbipeshës dhe të obezitetit.

Për përdorim epidemiologjik për grup-moshat që shtrihen brenda një viti (p.sh. për fëmijët e moshës 7.0-8.0 vjeç) vlera kufi e mesit të vitit (në këtë rast 7.5) u përdor për vlerësimin e gjendjes nutricionalë të fëmijëve të këtij studimi, pasi siguron një vlerësim thelbësor, të paanshëm të prevalencës (57).

Figura 1: Përkufizimi i obezitetit fëmënor sipas OBSH-së dhe IOTF-së

Organizata	Përkufizimi i obezitetit tek fëmijët
Organizata Botërore e Shëndetësisë	<i>OBSH Reference 2007 (5 deri 19 vjeç) (58)</i> • Obeze: Indeksi i masës trupore: BMI > 2 deviacion standard mbi medianën e kurbave standarde të rritjes OBSH • Mbipeshë: BMI > 1 deviacion standard mbi medianën e kurbave standarde të rritjes OBSH • Nëneshë: BMI < 2 deviacion standard nën medianën e kurbave standarde të rritjes OBSH
Task Forca Ndërkombëtare e Obezitetit	• Siguron vlerat kufi për moshën dhe gjininë e BMI-së së mbipeshës dhe të obezitetit tek fëmijët e moshës 2 deri 18 vjeç (57) • Këto vlera u korrespondojnë vlerave të një të rrituri me BMI 25 (mbipeshë) ose 30 (obezitet) • Nënkonsideron fëmijët me BMI më të vogël se 16, 17 dhe 18.5 të moshës adulte (59).

Figura 2: Vlerat kufi që u përdorën për përcaktimin e mbipeshës dhe të obezitetit tek fëmijët në baze të moshës dhe gjinisë (sipas Cole Jt et al.)

Mosha/vjeç	Nëneshë Mbipeshë Obeze		Mbipeshë BMI ekuivalente me 25 e të rriturve	Obeze	BMI ekuivalente me 30 e të rriturve	
M	M	F	F	M	F	
7	13.08	12.91	17.92	17.75	20.63	20.51
7.5	13.09	12.95	18.16	18.03	21.09	21.01
8	13.11	13.00	18.44	18.35	21.60	21.57
8.5	13.17	13.08	18.76	18.69	22.17	22.18
9	13.24	13.18	19.10	19.07	22.77	22.81
9.5	13.34	13.29	19.46	19.45	23.39	23.46
10	13.45	13.43	19.84	19.86	24.00	24.11
10.5	13.58	13.59	20.20	20.29	24.57	24.77

10. Klasifikimi i mëngjesit

Mëngjesi i fëmijëve u konsiderua cilësisht i përshtatshëm nëse përmbante ushqime të pasura me proteina dhe karbohidrate (të thjeshta ose komplekse). (60)

Ushqimet u grupuan në dy kategori:

1. Ushqime të pasura në qumësht dhe nënproduktet e tij.
2. Ushqime të pasura në karbohidrate si bukë, drithëra etj.

Mëngjesi u konsiderua i konsumuar kur fëmija raportonte marrjen e të paktën një ushqimi nga çdo kategori.

11. Bias të mundshëm

Në këtë studim, nuk ka evidencë të gabimeve sistematike (bias) të përzgjedhjes (seleksionimit) të kampionit meqenëse teknika e kampionimit ishte probabilitare (shih më lart).

Në mënyrë të ngjashme, u bënë përpjekje maksimale për shmangien e gabimeve sistematike të informacionit. Kështu, të gjithë intervistuesit dhe ekzaminuesit u trajnuan për një periudhë të

mjaftueshme sipas një protokolli standard për të shmangur variacionet e lidhura me gabimet ndërmjet-studiuesve/ekzminuesve. Po kështu, të gjithë fëmijët u intervistuan dhe u matën në mënyrë dhe në kushte sa me të ngjashme në të gjitha shkollat e përfshira në studim në të gjitha rrethet.

Prandaj, konsiderohet që gjetjet e këtij studimi nuk vuajnë nga gabimet sistematike, fakt i cili mundëson përgjithësimin e rezultateve në mbarë vendin.

12. Financimi i këtij studimi

Financimi i këtij studimi u bë i mundur nga Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSh) në kuadrin e Programit të Përbashkët të Ushqyerjes “Zvogëlimi i kequshqyerjes tek fëmijët”, i financuar nga Fondi Spanjoll i Objektivave të Zhvillimit të Mijëvjeçarit, si dhe nga Instituti i Shëndetit Publik.

13. Rezultate dhe diskutime

A. Gjendja nutricionalë e fëmijëve

Në studim u përfshinë 104 shkolla (ANEX 5: Lista e shkollave) të përzgjedhura nga 5 prefektura: Tirana, Elbasani, Vlora Berati dhe Shkodra.

Figura 3: Shpërndarja e shkollave të përfshira në studim sipas rretheve

Rrethet	Frekuenca në numër	Frekuenca në %	% e vlefshme	Frekuenca kumulative %
BERAT	9	8.7	8.7	
ELBASAN	19	18.3	18.3	8.7
SHKODËR	14	13.5	13.5	26.9
TIRANË	51	49.0	49.0	40.4
VLORE	11	10.6	8.7	89.4
TOTALI	104	100.0	100.0	100.0

Numri i fëmijëve të ekzaminuar ishte 5810, me një mesatare moshe prej 8.42 vjeç dhe medianë 8.43 vjeç, dhe një shpërndarje sipas gjinisë respektivisht 51.5 për qind meshkuj dhe 48.5 për qind femra. Fëmijët e zonave urbane përbënin 46.5 për qind të të gjithë fëmijëve kundrejt 53.5 për qind të atyre që vinin prej zonave rurale të përzgjedhura për studim.

Figura 4: Shpërndarja e fëmijëve 7-10 vjeç sipas gjinisë

Fëmijët	Frekuenca	Përqindja	Përqindja e vlefshme	Përqindja kumulative
Djem	2993	51.5	51.5	51.5
Vajza	2817	48.5	48.5	100.0
Totali	5810	100.0	100.0	

Figura 5: Shpërndarja e fëmijëve 7-10 vjeç sipas zonave urbane/rurale

Zonat	Frekuenca	Përqindja	Përqindje e vlefshme	Përqindja kumulative
Urban	2700	46.5	46.5	46.5
Rural	3110	53.5	53.5	100.0
Totali	5810	100.0	100.0	

Figura 6: Shpërndarja e fëmijëve sipas moshës dhe gjinisë

Fëmijët	Frekuenca	Përqindja	Përqindja e vlefshme	Përqindja kumulative
Djem 7-8	700	12.0	12.0	12.0
Djem 8-9	1711	29.4	29.4	41.5
Djem 9-10	582	10.0	10.0	51.5
Vajza 7-8	728	12.5	12.5	64.0
Vajza 8-9	1604	27.6	27.6	91.7
Vajza 9-10	485	8.3	8.3	100.0
Totali	5810	100.0	100.0	

Figura 7: Shpërndarja e fëmijëve sipas moshës/ gjinisë dhe zonave urbane/rurale

Fëmijët		Zona		Totali
		Urbane	Rurale	
Djem 7-8	numri	309	391	700
	%	44.1%	55.9%	100.0%
Djem 8-9	numri	780	931	1711
	%	45.6%	54.4%	100.0%
Djem 9-10	numri	286	296	582
	%	49.1%	50.9%	100.0%
Vajza 7-8	numri	337	391	728
	%	46.3%	53.7%	100.0%
Vajza 8-9	numri	755	849	1604
	%	47.1%	52.9%	100.0%
Vajza 9-10	numri	233	252	485
	%	48.0%	52.0%	100.0%
Totali	numri	2700	3110	5810
	%	46.5%	53.5%	100.0%
		100.0%	100.0%	100.0%

Nga fëmijët e ekzaminuar, 46.5% e tyre kishin konsumuar mëngjes ditën e matjeve antropometrike. Fëmijët e zonave rurale që konsumonin mëngjes ishin më të shumtë (53.1%) se ata të zonave urbane 46.9%.

Figura 8: Shpërndarja e konsumit të mëngjesit mes fëmijëve sipas zonave urbane/rurale

Konsumojnë mëngjes		Zona		Totali
		Urbane	Rurale	
Po	numri	1948	2202	4150
	%	46.9%	53.1%	100.0%
Jo	numri	752	908	1660
	%	45.3%	54.7%	100.0%
Totali	numri	2700	3110	5810
	%	46.5%	53.5%	100.0%

Figura 9: Shpërndarja e konsumit të mëngjesit mes fëmijëve sipas moshës dhe gjinisë

Fëmijët gjini/moshë		Konsumojnë mëngjes		Totali
		Po	Jo	
Djem 7-8	Numër	502	198	700
	%	71.7%	28.3%	100.0%
Djem 8-9	Numër	1256	455	1711
	%	73.4%	26.6%	100.0%
Djem 9-10	Numër	423	159	582
	%	72.7%	27.3%	100.0%
Vajza 7-8	Numër	516	212	728
	%	70.9%	29.1%	100.0%
Vajza 8-9	Numër	1115	489	1604
	%	69.5%	30.5%	100.0%
Vajza 9-10	Numër	338	147	485
	%	69.7%	30.3%	100.0%
Totali	Numër	4150	1660	5810
	%	71.4%	28.6%	100.0%


Të dhënat tregojnë një ndryshim jodomethënës të konsumit të mëngjesit mes fëmijëve të dy gjinive, me tendencë moskonsumimi pak më të lartë tek femrat (30.1%) në raport me meshkujt (27.7%). Mesatarisht në çdo katër fëmijë, më shumë se një fëmijë nuk konsumonte mëngjes.

Vlerësimi i gjendjes nutricionalë të fëmijëve u krye nëpërmjet përdorimit të BMI-së së përcaktuar sipas vlerave kufi të IOTF-së dhe OBSH-së (të trajtuara më lart).

Figurat në vijim tregojnë shpërndarjen e masës trupore të fëmijëve (BMI) sipas vlerave Kufi të Cole Jt et al.

Sipas Cole Jt et al rezultoi se 14.4% e fëmijëve ishin mbipeshë (përfshirë edhe obezitetin), prej të cilëve 3.3% obezë. Vetëm 1.6% e fëmijëve ishin të dobët (Figura 10).

Figura 10: Shpërndarja e BMI-së mes fëmijëve* sipas Cole Jt et al.



*Mbipesha në Figurën 10 nuk përfshin obezitetin.

Mbipesha ishte më e shprehur mes djemve të të tri grup-moshave në raport me vajzat, po kështu edhe obeziteti (Figura 11), me një ndryshim domethënës mes të dy gjinive ($p<0.001$).

Figura 11: Shpërndarja e BMI-se tek fëmijet 7-8 vjeç në bazë të gjinisë sipas Cole Jt et al




Figura 12: Shpërndarja e BMI-së te fëmijët 8-9 vjeç në bazë të gjinisë sipas Cole Jt et al.




Figura 13: Shpërndarja e BMI-së te fëmijët 9-10 vjeç në bazë të gjinisë sipas Cole Jt et al.





Figura 14: Shpërndarja e BMI-së te fëmijët 7-10 vjeç, të grupuar në bazë të moshës, sipas Cole Jt et al.



Nëse do të ndjekim prirjen e konsumit të mëngjesit mes fëmijëve, në bazë të gjendjes së tyre nutricionalë, do të vëmë re se me rritjen e BMI-së rritej edhe përqindja e fëmijëve që nuk konsumonin mëngjes (Figura 15).

Figura 15: Shpërndarja e fëmijëve në bazë të BMI-së dhe konsumit të mëngjesit Cole Jt et al


Konsumi i mëngjesit tek fëmijët		BMI COLE JT et AL*				Totali
		Normal	I dobët	Mbipeshë	Obezë	
Po	Numër	3520	65	451	114	4150
	%	72.2%	69.9%	69.8%	59.1%	71.4%
Jo	Numër	1358	28	195	79	1660
	%	27.8%	30.1%	30.2%	40.9%	28.6%
Totali	Numër	4878	93	646	193	5810
	%	84.0%	1,6%	11.1%	3.3%	100.0%

P=0.001

Për çdo fëmijë mbipeshë në fshat gjendeshin dy fëmijë mbipeshë në qytet (Figura 16), ndërsa obeziteti hasej **më shumë** në zonat urbane në raport me zonat rurale ku për çdo fëmijë në fshat

kishim tre fëmijë obezë në qytet, me një ndryshim domethënës të gjendjes së tyre nutricionalë në varësi të zonës së banimit (P<0.001).

Figura 16: Shpërndarja e BMI-së* në % mes fëmijëve sipas zonave urbane/rurale sipas Cole Jt et al



*P<0.001

Fëmijët u matën në varësi të orarit të tyre të mësimit në shkollë, ku një pjesë e tyre i frekuentonin ato paradite dhe një pjesë pasdite. Fëmijët e matur pasdite u pyetën edhe nëse ata kishin ngrënë drekë apo jo. Nga të dhënat (Figure 17), u vu re një ndikim jo i rëndësishëm i konsumit të drekës në gjendjen nutricionalë të fëmijëve (P=0.378).

Figura 17: Shpërndarja e BMI-së mes fëmijëve në bazë të kohës së matjeve, sipas Cole Jt et al.


			Koha e matjeve*		Totali
			Para drekës	Pas drekës	
BMI_ Cole Jt	Normal	Numër	3621	1257	4878
		%	74.2%	25.8%	100.0%
	I dobët	Numër	74	19	93
		%	79.6%	20.4%	100.0%
	Mbipeshë	Numër	465	181	646
		%	72.0%	28.0%	100.0%
	Obezë	Numër	141	52	193
		%	73.1%	26.9%	100.0%
Totali		Numër	4301	1509	5810
		%	74.0%	26.0%	100.0%

*P=0.378

Figurat në vazhdim tregojnë shpërndarjen e gjendjes nutricionalë të fëmijëve në bazë të BMI-së, së vlerësuar sipas vlerave kufi të përcaktuara nga OBSH-ja.

Pas analizës së të dhënave antropometrike, në bazë të vlerave kufi të përcaktuara nga OBSH-ja, rezultoi se prevalenca kombëtare e mbipeshës (përfshirë edhe obezitetin) të fëmijët e moshës 7-10 vjeç në Shqipëri është në vlerën 21.6% dhe prevalenca e obezitetit 7.7% (Figura 18)..

Figura 18: Shpërndarja e BMI-së* mes fëmijëve 7-10 vjeç, sipas sipas OBSH



*Mbipesha në grafik nuk përfshin obezitetin

Të dhënat e BMI-së së fëmijëve sipas grup-moshave dhe gjinisë, vënë në dukje tendencën e djemve për të qenë më shumë mbipeshë apo obezë krahasuar me vajzat e së njëjtës grup-moshë.

Figurat në vijim (Figurat 19-22) pasqyrojnë gjendjen nutricionalë të fëmijëve në bazë të të dhënave antropometrike sipas grup-moshave për gjini të ndryshme, sipas OBSH-së.

Figura 19: Shpërndarja e BMI-së tek fëmijët 7-8 vjeç në bazë të gjinisë sipas OBSH-së




Figura 20: Shpërndarja e BMI-së tek fëmijët 8-9 vjeç në bazë të gjinisë sipas OBSH-së




Figura 21: Shpërndarja e BMI-së tek fëmijët 9 -10 vjeç në bazë të gjinisë sipas OBSH-së





Figura 22: Shpërndarja e BMI-së tek fëmijët 7-10 vjeç, të grupuar në bazë të moshës, sipas OBSH-së



Numri i fëmijëve që nuk konsumonin mëngjes është më i lartë mes fëmijëve obezë në raport me fëmijët e tjerë (35.8%), por pa ndonjë korrelacion domethënës të kësaj difference mes tyre (P=0.003) (Figura 23).

Figura 23: Shpërndarja e fëmijëve në bazë të BMI-së dhe konsumit të mëngjesit- OBSH.


Konsumi i mëngjesit te fëmijët*		BMI_OBSH				Totali
		Normal	I dobët	Mbipeshë	Obez	
Po	Numër	3222	67	574	287	4150
	%	72.3%	67.7%	71 %	64.2%	71.4%
Jo	Numër	1233	32	235	160	1660
	%	27.7%	32.3%	29%	35.8%	28.6 %
Totali	Numër	4455	99	809	447	5810
	%	76,7%	1,7%	13,9%	7,7%	100,0%

*P=0.003

E njëjta dukuri në lidhje me konsumin e mëngjesit vihet re tek fëmijët, sikurse në rastin e analizës sipas Cole Jt et al, ku fëmijët mbipeshë dhe obezë konsumonin mëngjes në një përqindje më të ulët se fëmijët normalë, por ky ishte një ndryshim jodomethënës (P=0.003) mes tyre.

Fëmijët mbipeshë dhe obezë gjendeshin më së shumti në zonat urbane (59.6 % mbipeshë dhe 72% obezë) në raport me zonat rurale (40.4% dhe 28% respektivisht) me një ndryshim domethënës të gjendjes së tyre nutricionalë në varësi të zonës së banimit (P<0.001) (Figura 24)..

Figura 24: Shpërndarja e BMI-së në përqindje mes fëmijëve sipas zonave* urbane-rurale -OBSH



*P<0.001

Figura 25 tregon se nuk u ndesh ndonjë diferencë e ndjeshme mes gjendjes nutricionalë të fëmijëve dhe konsumit të drekës ($P=0.15$).


Figura 25: Shpërndarja e BMI-së mes fëmijëve në bazë të kohës së matjeve, sipas OBSH-së

			Koha e matjeve*		Totali
			Para drekës	Pas drekës	
BMI-OBSH	Normal	Numër	3316	1139	4455
		%	74.4%	25.6%	100.0%
	I dobët	Numër	80	19	99
		%	80.8%	19.2%	100.0%
	Mbipeshë	Numër	584	225	809
		%	72.2%	27.8%	100.0%
	Obez	Numër	321	126	447
		%	71.8%	28.2%	100.0%
Totali		Numër	4301	1509	5810
		%	74.0%	26.0%	100.0%

* $P=0.15$

Nëse do të krahasojmë gjendjen nutricionalë të fëmijëve 7-10 vjeç, të vlerësuar sipas dy referencave të përdorura: IOTF-së dhe OBSH-së (Figura 26), do të vëmë re se duke qenë se vlerat kufi të përcaktuara nga OBSH-ja janë më të ulëta përse i përket mbipeshës dhe obezitetit, atëherë edhe prevalenca e fëmijëve mbipeshë dhe obezë rezulton më e lartë, kur BMI-ja e tyre vlerësohet me normat e OBSH-së.

Figura 26: Shpërndarja e BMI-së tek fëmijët 7-10 vjeç, sipas Cole Jt et al dhe OBSH- së



B. Mjediset shkollore

Pjesë e studimit ishte edhe plotësimi nga ana drejtuesve të shkollave (në mungesë apo pamundësi të tyre, nga mësuesit e klasave të përfshira në studim) e një pyetësi që synonte vlerësimin e disa karakteristikave të klasave në studim si: strukturat e mjediseve sportive, orët e edukimit fizik që zhvilloheshin nga nxënësit në shkollë, programeve apo iniciativave për të promovuar një mënyrë jetese të shëndetshme (p.sh. aktivitete fizike dhe/ose ushqyerje të shëndetshme) për nxënësit e secilës klase të përfshirë në projekt, mjediseve të jashtme ose të brendshme ku fëmijët mund të luajnë zakonisht gjatë pushimeve mes orëve të mësimi, aksesin nga nxënësit për ushqime/pije të ndryshme në mjediset e shkollës, sigurinë e rrugëve për në shkollë dhe në shtëpi për nxënësit për të ecuar ose për të ngarë biçikletën.

Figurat në vijim ofrojnë informacionin e grumbulluar nga pyetësorët e kthyer nga shkollat e intervistuar. Formularët u grumbulluan nga 104 shkolla të pesë prefekturave të përfshira në projekt, të plotësuar në rreth 48% të rasteve nga drejtuesit e tyre (Figura 27) dhe në 52% të rasteve nga mësuesit.

Figura 27: Shpërndarja e plotësimit të formularëve sipas pozicionit në shkollë

	Frekuenca	Përqindja	Përqindja e vlefshme	Përqindja kumulative
Drejtues shkolle	50	48.1	48.1	48.1
Mësues	54	51.9	51.9	100.0
Total	104	100.0	100.0	

Pyetjes nëse shkolla zotëron mjedise të jashtme ose të brendshme ku fëmijët mund të luajnë zakonisht gjatë pushimeve mes orëve të mësimi, 84 shkolla iu përgjigjen pozitivisht (ose 80.8% e tyre) kundrejt 20 shkollave të cilat nuk dispononin mjedise të tilla. E thënë ndryshe, një në pesë shkolla nuk zotëronte një mjedis të përshtatshëm ku fëmijët të mund të luajnë gjatë pushimit.

Aktiviteti fizik, i ushtruar nga nxënësit, ishte një tjetër aspekt i studimit. Programi mësimor i aprovuar nga Ministria e Arsimit dhe e Shkencës parashikon për klasat e arsimit fillor, në kuadrin e kurrikulës së detyruar për çdo klasë, zhvillimin e 2 orëve të edukimit fizik me 45 minuta/për secilën me një total prej 90 minutash në javë.

